



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 263/1 prot.

Tiranë, më 20.02.2018

VENDIM

Nr.6, datë 20.02.2018

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 26, DATË 21.03.2016, NË
INSTITUCIONIN E BASHKISË VLORË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 26, datë 21.03.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Vlorë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë”,

KONSTATOVA SE:

Me Vendimin nr. 121, datë 05.11.2015, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Vlorë”, është nisur mbikëqyrja tematike në këtë subjekt. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 26, datë 21.03.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Vlorë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

2. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Vlorë, si struktura përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore në këtë institucion, që të rregullojë pasojat lidhur

me punonjësit të cilët nuk përmbushin kriteret për të qenë nëpunës civilë, për shkak se nuk plotësojnë nivelin arsimor, si më poshtë:

- ***** , në pozicionin e punës “Specialist Infrastruktura”;
- ***** , në pozicionin e punës “Specialist Infrastruktura”;
- ***** , në pozicionin e punës “Inspektor Tatimesh”;
- ***** , në pozicionin e punës “Përgjegjës i Zyrës së Financës”;
- ***** , në pozicionin e punës “Specialist i Ndhmës Ekonomike”;
- ***** , në pozicionin e punës “Përgjegjës Tatim Taksash”.

Në këtë rast, njësia përgjegjëse duhet të rregullojë situatën, duke kryer veprimet sipas këtij rendi:

- Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit si nëpunës civil dhe të përfundimit të marrëdhënies së punësimit për këta punonjës, duke evidentuar faktin se ata nuk i përmbushin kriteret për të qenë nëpunës civilë, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Pozicionet e punës duhet të shpallen të lira, për t’u plotësuar më tej në përputhje me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Vlorë.

3. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Vlorë, të nxjerrë aktet e deklarimit të statusit të punësimit përkatësisht:

- ***** , në pozicionin e punës “Administrator i Rajonit”;
- ***** , në pozicionin e punës “Administrator i Rajonit”;
- ***** , në pozicionin e punës “Administrator i Rajonit”;
- ***** , në pozicionin e punës “Administrator i Rajonit”;
- ***** , në pozicionin e punës “Administrator i Rajonit”;
- ***** , në pozicionin e punës “Specialist Infrastruktura”;
- ***** , në pozicionin e punës “Specialist Infrastruktura”;
- ***** , në pozicionin e punës “Specialist Infrastruktura”.
- ***** , në pozicionin e punës “Specialist IT”;
- ***** , në pozicionin e punës “Specialist i Nivelit të Lartë për Tregjet”
(pavarësisht se aktualisht, ai punon në një pozicion pune që nuk është pjesë e shërbimit civil).

4. Të plotësohen dosjet e personelit për këta punonjës konkretisht, ***** , ***** , ***** dhe të vijojë procesi i deklarimit të statusit të tyre të punësimit.

5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30 ditë** nga marrja dijani për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e materializuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues nr. 26, datë 21.03.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Vlorë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë”, me Vendimin Nr. 112, datë 04.05.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 26, datë 21.03.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Vlorë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë””, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të këtij vendimi.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Stela Ndoka dhe Helga Peti, Specialistë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Bashkisë Vlorë dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 324/1 prot., datë 04.05.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr.26, datë 21.03.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të Shërbimit civil në Bashkinë Vlorë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë”.

Grupi i punës u paraqit pranë institucionit të Bashkisë Vlorë në datën 11.05.2017. Për shkak të rikonstruksionit të kësaj bashkie, procesi i verifikimit u shty për një kohë të mëvonshme. Ky proces u finalizua në datën 23.11.2017, pas njoftimit të njësisë së burimeve njerëzore. Gjatë vizitës në subjekt, grupi i punës komunikoi me Drejtoreshën e Burimeve Njerëzore, nga ana e së cilës u pretendua se materialet shkresore të cilat materializonin zbatimin e vendimit nuk mund t’i vireshin në dispozicion grupit të punës, për shkak se rikonstruksioni nuk kishte përfunduar ende, por do të dërgoheshin me postë. Sa më sipër është pasqyruar në procesverbalin e datës 23.11.2017, të mbajtur midis grupit të punës të Komisionerit dhe Drejtores së Burimeve Njerëzore të Bashkisë.

Në vijim, me shkresën nr. 3685/3 prot., datë 30.11.2017, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Vlorë, Komisioneri është informuar për masat e marra në lidhje me zbatimin e vendimit paralajmërues nr. 26, datë 21.03.2016.

Sa më sipër, grupi i punës vëren se:

Në pikën 2 të Vendimit paralajmërues i është lënë detyrë njësisë përgjegjëse që të rregullojë pasojat lidhur me punonjësit *****, *****, *****, *****, ***** dhe *****, të cilët nuk përmbushin kriteret për të qenë

nëpunës civilë, për shkak se nuk plotësojnë nivelin arsimor, duke vendosur refuzimin e statusit si nëpunës civil dhe përfundimin e marrëdhënies së punësimit, e më tej, shpalljen e këtyre pozicioneve të lira.

Pas shqyrtimit të akteve bashkëngjitur shkresës nr. 3685/3 prot., datë 30.11.2017, të Drejtorit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Vlorë, rezulton se janë marrë masat e mëposhtme:

- Me aktin nr. 3685/2 prot., dt. 24.11.2017, është bërë refuzimi i statusit si nëpunës civil për punonjës në ***** në pozicionin e punës, “*Specialist Infrastruktura*”, për shkak se nuk plotëson nivelin arsimor. Me vendimin nr. 12, datë 28.02.2017, “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Vlorë dhe institucioneve të varësisë dhe funksioneve të transferuara për vitin 2017*”, pozicioni “*Specialist Infrastruktura*”, të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, ka kaluar jashtë shërbimit civil, duke ndryshuar edhe emërtesë në “*Punonjës infrastruktura*”.
- Me aktin nr. 3685/2 prot., dt. 24.11.2017, është bërë refuzimi i statusit si nëpunës civil dhe përfundimi i marrëdhënies së punës për punonjës në ***** në pozicionin e punës, “*Përgjegjës i Zyrës së Financës*”, për shkak se nuk plotëson nivelin arsimor.
- Me aktin nr. 3685/2 prot., dt. 24.11.2017, është bërë refuzimi i statusit si nëpunës civil dhe përfundimi i marrëdhënies së punës për punonjës në ***** në pozicionin e punës, “*Inspektor Tatimesh*”, për shkak se nuk plotëson nivelin arsimor.
- Me aktin nr. 3685/2 prot., dt. 24.11.2017, është bërë refuzimi i statusit si nëpunës civil dhe përfundimi i marrëdhënies së punës për punonjës në ***** në pozicionin e punës, “*Përgjegjës Tatim Taksash*”, për shkak se nuk plotëson nivelin arsimor.

Nga pikëpamja formale, rezulton se aktet e mësipërme, pavarësisht se janë nxjerrë në mënyrë nominale për secilin nga punonjësit, ato janë nxjerrë në kuptim të gabuar të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “*Për arkivat*” dhe nenit 19, pika 1, të “*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në të cilin parashikohet se: “... Nuk lejohet evidencimi në një numër i dy ose më shumë praktikave të përafërta që janë të pavarura ndërmjet tyre sipas objektit.”, për shkak se ato mbajnë të njëjtin numër protokoll. Megjithatë, kjo parregullsi e karakterit formal nuk është e tillë që të cenojë vlefshmërinë e këtyre akteve.

Veç kësaj, konstatoj se, për punonjës in ***** nuk është nxjerrë akti i refuzimit të statusit si nëpunës civil. Ndërkohë pozicioni “*Specialist Infrastruktura*” i mbajtur prej tij, me vendimin nr. 12, datë 28.02.2017, “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Vlorë dhe institucioneve të varësisë dhe funksioneve të transferuara për vitin 2017*”, të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, ka kaluar jashtë shërbimit civil, duke ndryshuar edhe emërtesë në “*Punonjës infrastrukture*”.

Po kështu, edhe për punonjës in ***** nuk është nxjerrë akti i refuzimit të statusit si nëpunës civil. Referuar shkresës Nr. 9730/1 prot., datë 25.11.2016, “*Kthim përgjigje*”, drejtuar Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Bashkia Vlorë ka sqaruar ndër të tjera se marrëdhënia e punësimit për këtë punonjëse në pozicionin “*Specialist i ndihmës ekonomike*” në Njësinë Administrative Qendër është ndërprerë në momentin e zbatimit të reformës territoriale, për shkak të mospërputhjes së kriterëve dhe shkurtimit të vendit të punës (*ky pozicion nuk ekziston në strukturën aktuale*).

Pavarësisht parregullsive të evidentuara më sipër, theksoj se kjo pikë e dispozitivit të vendimit të Komisionerit do të konsiderohet e zbatuar, duke i tërhequr vëmendjen njësisë së burimeve njerëzore të institucionit që në të ardhmen të zbatojë me korrektësi legjislacionin në fuqi dhe rekomandimet e Komisionerit.

Në pikën 3 të Vendimit, i është lënë detyrë njësisë përgjegjëse (njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore) të institucionit, të nxjerrë aktet e deklarimit të statusit të punësimit përkatësisht për punonjës it ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** dhe ***** .

Në zbatim të kësaj kërkesë, nga aktet e administruara konstatoj se njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore ka nxjerrë aktet e deklarimit të statusit të punësimit në pozicionet përkatëse, në mënyrë nominale për të gjithë punonjës it e mësipërm (*në përputhje me rekomandimin e Komisionerit*), por edhe në këtë rast ato mbajnë të njëjtin numër protokollit (*nr. 3685/1 prot., datë 24.11.2017*).

Sikundër është analizuar gjatë zbatimit të pikës 2 të vendimit objekt verifikimi, kjo parregullsi duhet të mbahet parasys h nga njësia përgjegjëse, për të mos u përsëritur më në të ardhmen.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve ***në pikën 4 të vendimit*** paralajmërues të Komisionerit, në të cilën njësisë përgjegjëse i është lënë detyrë që të plotësojë dosjet e personelit për punonjës it ***** , ***** dhe ***** , dhe më tej të vijojë procesin e deklarimit të statusit të tyre të punësimit, konstatoj se ajo nuk është realizuar për faktin se, nga komunikimi me këtë njësi, 3 punonjës it e mësipërm nuk kanë qenë pjesë e

strukturave të ish Komunave dhe Bashkive në momentin e zbatimit të reformës territoriale dhe dosjet e tyre nuk i janë përcjellë Bashkisë Vlorë.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 26, datë 21.03.2016, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Vlorë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë”*, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit janë bërë përpjekje për të zbatuar rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 26, datë 21.03.2016, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Vlorë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit të Bashkisë Vlorë, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr.26, datë 21.03.2016.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Vlorë dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha